



11



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

KUADRI LIGJOR PËR INVESTIMET, DEBATET DHE SFIDAT

Tiranë, Qershor 2018

Ky dokument pune është përgatitur në kuadër të mbledhjes XIII të Këshillit të Investimeve (18 qershor 2018) nga z. Elvis Zerva, ekspert ligjor i Sekretariatit, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Ndihmoi në redaktimin gjuhësor të materialit dhe në përkthim (anglisht-shqip), znj. Elisa Lula, oficere administrative dhe komunikimit e Sekretariatit.

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
Vlerësim aktual mbi klimën e investimeve në vend	6
Kuadër ligjor liberal me objektiva ambicioze për të arritur potencialin e investimeve	9
Problematikat më kryesore të evidentuara nga diskutimet mbi kuadrin ligjor në fushën e investimeve	14
Mbi disa modele të mekanizmit të trajtimit të ankesave të investitorëve në vende të ndryshme	17
HAPAT NË VIJIM	19
SHTOJCA 1	21
SHTOJCA 2	24

HYRJE

Në kuadrin e proceseve integruese të vendit në BE dhe atyre në nivel rajonal¹ është formalizuar tashmë Reforma për Zonën Ekonomike Rajonale (REA). Një komponent i REA është edhe axhenda për investimet (RIRA)², e cila synon midis të tjerave edhe një harmonizim të kuadrit ligjor dhe rregullator të investimeve në vend me praktikatat më të mira ndërkombëtare (*Shtojca 1*).

Që në prill 2016, në kuadër të analizës “Incentivat Për Nxitjen e Investimeve: Shqipëria Përballë Vendeve të Ballkanit”, Këshilli i Investimeve (KI) ka nënvizuar se *në krahasim me vendet e rajonit, paketa e ligjeve dhe e akteve nënligjore është ambicioze dhe me objektiva strategjike*³.

¹ Western Balkans Regional Economic Area Initiative

² Në maj 2018, në kuadrin e nismës rajonale të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor u formalizua në Tivat, Mal i Zi, Axhenda Rajonale për Investimet (RIRA). Qëllimi i RIRA është harmonizimi më i madh i politikave të investimeve të WB6 me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, në kuadër të Strategjisë së Evropës Juglindore 2020, Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe proceseve të para-anëtarësimit dhe pranimit në BE.

³ Ligji për Investimet Strategjike shënjestron kategori të investitorëve potencialë me kapitale të larta sipas sektorëve

Nga konsultimet e kryera në atë kohë nga Sekretariati i KI, rezultonte se investitorët e vlerësonin pozitivisht kuadrin ligjor ekzistues, por ishin skeptikë me efektivitetin e zbatimit të tij⁴. Midis të tjerash rezultonte se ndonëse me një legjislacion liberal, jo diskriminues për investitorët e huaj, ende mbetej mjaft për t’u bërë në drejtim të transparencës së incentivave dhe programeve sektoriale; kufizimeve të interpretimeve “të diskutueshme” diskrecionare të ligjeve dhe akteve nënligjore nga ana e autoriteteve kompetente apo nevojave për thjeshtimin e mëtejshëm të procedurave burokratike administrative.

Theksojmë se kohët e fundit ka pasur disa iniciativa si nga donatorët (IFC/SECO), ashtu edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në drejtim të diskutimit mbi procesin e përditësimit dhe harmonizimit të legjislacionit aktual në fushën

të shpallur strategjikë. Kufinj të minimalë monetarë të investimeve të propozuara janë të tillë të cilët synojnë rritje të menjëhershme të fluksit të investimeve të huaja në vend. Për më shumë detaje referoju Shtojcës 2.

⁴ P.sh. kufinj të minimalë monetarë të investimeve të propozuara për t’u konsideruar si strategjike konsideroheshin si mjaft të lartë.

e investimeve. Në këtë kontekst, Sekretariati i KI në bashkëpunim me ekspertë të IFC/SECO dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, organizoi edhe një konsultim me palët e interesuara mbi opsionet e “harmonizimit të kuadrit ligjor aktual të investimeve me praktikatat më të mira ndërkombëtare”. Në këtë takim morën pjesë mbi 60 pjesëmarrës, përfaqësues të Dhomave të Tregtisë dhe Shoqatave të Biznesit, bizneseve vendase dhe të huaja me prezencë të rëndësishme për ekonominë shqiptare dhe studiove të konsulencës në fushën ligjore dhe tatimore.

Aktualisht, diskutimet për përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues në fushën e investimeve mund të përmbledhen rreth dy shtyllave kryesore: 1) A është kuadri ligjor ekzistues i harmonizuar me rekomandimet e praktikave më të mira ndërkombëtare sikurse janë rekomandimet e UNCTAD;⁵ 2) A është ky kuadër motivues dhe “i zbatueshëm” për investitorët vendas dhe të huaj për të zgjedhur Shqipërinë si destinacionin e tyre për investime të reja?

Në këtë kontekst, në fazën aktuale është e rëndësishme të qartësohet nëse “diskutimet apo nevojat për përmirësim” lidhen me: a) kuadrin ligjor ekzistues për investimet e huaja; b) incentivat dhe investitorët strategjikë; c) funksionimin e mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve/ankesave të investitorëve (IGM)⁶; apo d) me një kuadër pak më të gjerë të mjedisit ligjor dhe

⁵ World Investment Report 2018-UNCTAD

⁶ IGM-Investment Grievance Mechanisms (anglisht)

klimes së investimeve që lidhen me problemet e shtetit të së drejtës, paqëndrueshmërinë e legjislacionit, rolin e administratës dhe institucioneve (përfshirë këtu edhe AIDA), sistemin e dobët të drejtësisë, konkurrencën e pandershme dhe ekonominë informale.

Qartësimi i qëndrimeve nëpërmjet debatit mbi çështjet e mësipërme do të shërbejë për të lehtësuar vendimmarrjen drejt një kuadri ligjor mbi investimet sa më të “dakordësuar”. Në fazën aktuale akoma nuk ka një draft-ligj apo kuadër të dakordësuar që mund të ndahet paraprakisht për konsultim me anëtarët e KI⁷.

Ky dokument, përmbledh dhe parashtron aspektet kryesore të diskutimeve të evidentuara mbi kuadrin ligjor të investimeve, duke patur në konsideratë kontekstin e legjislacionit aktual prej miratimit të Ligjit “Për Investimet e Huaja” në vitin 1993 e deri më sot, punën dhe mendimet e ekspertëve të huaj dhe vendas që asistojnë reformat në këtë drejtim⁸, procesin e konsultimit në grupet e punës dhe me grupet e interesit në gjysmën e parë të 2018. Gjithashtu, një matricë krahasuese e instrumentave për zgjidhjen e mosmarrëshjeve të investitorëve në 6 vende të ndryshme përgatitur nga Sekretariati jepet në Shtojcën 2.

⁷ Në mungesë të një drafti paraprak si bazë diskutimi, në përmbledhje nuk janë përfshirë komentet dhe rekomandimet specifike të Sekretariatit.

⁸ Ekspertë të IFC kanë detajuar praktikatat më të mira që mund të konsiderohen në procesin e harmonizimit të legjislacionit shqiptar konsultuar me një grup pune nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për të aksesuar materialin, kliko [këtu](#).

VLERËSIM AKTUAL MBI KLIMËN E INVESTIMEVE NË VEND


Investimet (private apo publike) vlerësohet të përfaqësojnë motorin kryesor për të garantuar rritjen e ekonomisë së vendit në terma afatmesëm dhe afatgjatë. Gjithashtu, ri-orientimi i ekonomisë drejt një modeli të bazuar në investime (dhe eksporte) krijon bazën për një zhvillim të qëndrueshëm në terma afatmesëm dhe afatgjatë.⁹

Ndër vite, ecuria e investimeve publike ka qenë e luhatshme në varësi edhe të përparësive politike dhe treguesve buxhetore në kohë. Ashtu si mund të evidentohet dhe nga

llogaritë kombëtare të paraqitura në Fig. 1, flukset e investimeve të huaja direkte kanë mbështetur ekonominë vendase në mënyrë të qëndrueshme. Rëndësia e tyre evidentohet veçanërisht pas vitit 2009, kur raporti i fluksit të IHD-ve ndaj PBB-së regjistroi një nivel më të lartë krahasuar me nivelin e investimeve publike ndaj PBB-së nominale. Ndërkohë që treguesi i investimeve publike ndaj PBB-së ndoqi prirje rënëse nga viti në vit, ai i IHD-ve vijoi të ndjekë trend pozitiv ndonëse me luhatje.

⁹ Në dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet, ndër shtyllat për një rritje ekonomike të qëndrueshme citohet "sigurimi i rritjes nëpërmjet konkurrueshmërisë dhe të novacioneve" (SKIZH 2015-2020, faqe 33). Përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrueshmërisë përbën një objektiv strategjik kombëtar, ndër të tjera nëpërmjet "promovimit të biznesit dhe të investimeve të huaja direkte".

Figura 1. Investimet publike dhe IHD-të ndaj PBB-së nominale



Në vitin 2017, investimet e huaja u konsideruan si katalizatorët kryesorë të rritjes ekonomike, duke qenë se fluksi i IHD-ve arriti në 8% të PBB ndërkohë që investimet publike mesatarisht në vite kanë qenë 4-5 % të PBB.

Një faktor i rëndësishëm i potencialit për rritjen e investimeve konsiderohet mirëqeverisja, një sistem i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm tak-sash, rregulla dhe ligje të qëndrueshme si edhe një sistem efikas i dhënies së shërbimeve publike.


Sipas *Doing Business 2018*, Shqipëria renditet në vendin e 65 nga 190 vende, ku ndër indikatorët e vlerësu-

ar më pozitivisht janë mbrojtja e investitorëve të pakicave, tregtia përtej kufijve dhe marrja e kredisë.

Në Raportin e Progresit të BE (2018) njihet progresi i Shqipërisë sa i përket kriterit ekonomik dhe evidentohen reformat që Shqipëria ka bërë për përmirësimin e mjedisit të biznesit, por kërkohen përpjekje të mëtejshme, duke përfshirë zvogëlimin e ekonomisë informale.

Sipas *Indeksit të Konkurrueshmërisë Globale për 2017-2018*, Shqipëria renditet në vendin e 75-të nga 137 vende të përzgjedhura, me rezultatin më të lartë në krahasim me vendet e tjera të rajonit.

Figura 2. Renditja e Shqipërisë në 'Indeksin e Konkurrueshmërisë Globale, 2017-2018'



Sipas vlerësimit të përgjithshëm të Departamentit të Shtetit të SHBA (2017), mbi kuadrin ligjor të investimeve në Shqipëri nënvizohet se “*legjislacioni ofron garanci tek të gjithë investitorët (persona fizik ose juridik) që duan të investojnë në Shqipëri*”. Pavarësisht optimizmit që përcjellin, raportet ndërkombëtare nënvizojnë nevojën për: a) reforma të mëtejshme strukturore dhe institucionale; b) zbatimin e reformës në administratën publike; c) përafrimin e legjislacionit

vendas me *acquis communautaire*; d) regjistrimin përfundimtar të pronave dhe zgjidhjen e çështjeve të pronësisë; d) pritshmëritë e larta për rezultatet e reformës në sistemin e drejtësisë. Theksojmë se kjo e fundit është identifikuar edhe nga vetë shoqatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë në vend si një nga reformat më të domosdoshme e cila pritet të rrisë në një shkallë të re optimizmin për klimën e biznesit në vend.

Kuadër ligjor liberal me objektiva ambicioze për të arritur potencialin e investimeve

Ekzistenca e një legjislacioni të përshtatshëm i cili iu jep investitorëve garancitë juridike për mbrojtjen e investimeve dhe barrierat minimale administrative vlerësohen si instrumenta të rëndësishëm për thithjen e investimeve. Shqipëria ka adoptuar prej kohësh një legjislacion liberal veçanërisht sa i takon investimeve të huaja në vend i mbështetur në parimin e mosdiskriminimit ndërmjet investitorëve vendas dhe të huaj. Kuadri ligjor për shoqëritë tregtare si rregull nuk parashikon barriera për themelimin e shoqërive tregtare me kapital 100% të huaj¹⁰. Më konkretisht:

- » Themelimi i shoqërive tregtare¹¹ nga investitorët e huaj mund të bëhet lirisht dhe pa nevojën e ndonjë miratimi apo autorizimi paraprak sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, të cilat janë të njëjta edhe për investitorët vendas.
- » Nuk ka kufizime për blerjen e pronës private për qëllime banimi. Të huajt mund të fitojnë të drejta koncesioni në burimet natyrore dhe në burimet me interes të përbashkët, siç përcaktohet me *Ligjin për Konçesionet dhe Partneritetet Publiko-Private*.
- » Kufizime aplikohen vetëm për blerjen e pasurive të paluajtshme, sipas të cilit toka bujqësore nuk mund të blihet nga shtetas ose shoqëri të huaja, por mund të merren me qira

¹⁰ Sipas legjislacioni shqiptar, 100 për qind e pronësisë së huaj është e lejuar në pothuajse të gjithë sektorët me disa përjashtime, duke përfshirë:

- Transporti ndërkombëtar ajror i udhëtarëve ajror (i kufizuar në 49% të pronësisë për investitorët jashtë Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit);
- Transmetimi i energjisë elektrike (i cili duhet të jetë 100% në pronësi të shtetit);
- Transmetime televizive (asnjë subjekt nuk mund të ketë më shumë se 40% të aksioneve të një kompanie televizive). Shtetasve të huaj u ndalohet të zotërojnë më shumë se 49%

të kapitalit të një anijeje me flamur shqiptar ose të shoqërive tregtare me aktivitet në peshkimin tregtar.

¹¹ Sipas Raportit Doing Business 2017, për të themeluar një shoqëri tregtare në Shqipëri duhen mesatarisht 5 procedura përgjatë 5 ditëve.

deri në 99 vjet¹². Pasuritë e tjera me karakter komercial mund të blihen, por vetëm nëse investimi i propozuar është me vlerë tri herë më të lartë sesa çmimi i tokës¹³.

Ligjet më të rëndësishme të cilat adresojnë çështje që lidhen edhe investimet janë:

- » Ligji Nr. 7764/1993 *“Për Investimet e Huaja”* i ndryshuar me Ligjin Nr. 10316 datë 126.09.2010 dhe Ligjin Nr. 46/2017 datë 13.04.2017.
- » Ligji Nr.55/2015 *“Për Investimet Strategjike”*¹⁴.
- » Ligji Nr. 9789/2007 *“Për Krijimin dhe Funkcionimin e Zonave Ekonomike”* ndryshuar me Ligjin Nr. 54/2015 *“Për Krijimin dhe Funkcionimin e Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik”*¹⁵ i cili parashikoi incentiva fiskale konkrete për veprimtaritë ekonomike të industrive të reja, teknologjive novatore, teknologjive të informacionit, industrive që përmbushin standardet ndërkombëtare të

12 Ligji Nr. 8337, datë 30.04.1998 *“Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”*.

13 Ligji “Per Shitblerjen e Trojeve” Nr. 7980, datë 27.07.1995, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8260, datë 26.11.1997

14 Ligji për Investimet Strategjike Nr. 55/2015, mundëson ligjërisht që investimet e huaja në sektorët më të rëndësishëm të lëvizin më me shpejtësi dhe të shmangen pengesat e shumta joproduktive dhe administrative që dalin përpara investitorëve. Vlerësimi i efektivitetit të këtij ligji relativisht të ri në kohë, duhet konsideruar në raport me numrin e investitorëve strategjikë që kanë marrë statusin përkatës, vlerave të investimeve të parashikuara dhe impaktin ekonomik në përgjithësi që kanë patur këto investime.

15 Me anë të këtyre ndryshimeve të gjitha emërtimet e mëparshme, “zona ekonomike”, “zona e lirë” dhe parqet industriale, zëvendësohen me TEDA. Ky ligj garanton: a) Parashikueshmëri—shërbime qeveritare në një dritare unike për zhvilluesit dhe përdoruesit e TEDA; afat të gjatë për marrjen me qira të TEDA; mundësi të arbitrazhit ndërkombëtar. b) Produktivitet—Infrastrukturë e besueshme; sigurimi i përpunimit pasiv për produktet e TEDA; incentiva fiskale për zhvillim-kërkim dhe trajnimin e fuqisë punëtore; c) Përfitueshmëria—Përrjashtime nga taksat doganore dhe nga TVSH në lidhje me mallrat, lëndët e para dhe makineri për zhvilluesit, përdoruesit dhe operatorët e TEDA; incentiva fiskale dhe përrjashtime nga tatimi mbi të ardhurat dhe mbi ndërtesat; incentiva për rritjen e punësimit. d) Incentiva administrativë dhe proceduriale.

eliminimit të ndotjes, industrive efçente në përdorimin e energjisë, si dhe industrive me produktivitet të lartë, në raport me punonjësit.

- » Ligji Nr. 9901/2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”* përcakton rregullat për themelimin dhe organizimin e tregtarëve dhe shoqërive tregtare.
- » Ligji Nr. 110/2002 *“Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive Tregtare”*. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve, procedurave dhe pasojave juridike të një bashkimi ndërkufitar ndërmjet shoqërive shqiptare dhe shoqërive evropiane, si dhe parashikimi i masave mbrojtëse për punëmarrësit dhe kreditorët e këtyre shoqërive.
- » Ligji Nr. 9121/2003 *“Për Mbrojtjen e Konkurrencës”*. Parashikon rregulla për mbrojtjen e konkurrencës dhe përqendrimin e shoqërive tregtare.
- » Ligji 10198/2009 *“Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”* (i ndryshuar). Ky ligj vendos kushtet dhe kriteret për ngritjen, krijimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve të investimeve kolektive dhe kompanive të menaxhimit.

Ndërkohë, Shqipëria është palë edhe në 43 Marrëveshje Dypalëshe për Investime (BIT)¹⁶ (nga të cilat 37 janë në fuqi) të nënshkruara në periudhën 1993-2013 me shtete të tjera. Parashikimet e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare prevalojnë mbi parashikimet e legjislacionit të brendshëm në rast të mospërputhjeve të mundshme ndërmjet tyre.

16 Bilateral Investment Treaty- <http://investmentpolicyhub.unctad.org/IIA/IiasByCountry#iialnnerMenu>

1. LIGJI NR. 7764, DATË 2.11.1993 “PËR INVESTIMET E HUAJA”

Ky ligj është i dedikuar vetëm për investimet e huaja¹⁷ dhe përmban garancitë e përgjithshme që shteti shqiptar ofron për shtetasit apo shoqëritë e huaja të cilat kryejnë aktivitet ekonomik në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Garancitë kryesore për investitorët e huaj sipas këtij ligji janë:

- » Lejon 100% pronësi të huaj mbi shoqëritë e themeluara në Republikën e Shqipërisë. Nuk ka kufizim lidhur me kuotat/aksionet dhe numrin e investitorëve të huaj në një kompani (pronësia e huaj 100% është e mundur);
- » Investimet e huaja lejohen dhe trajtohen në pozita të barabarta me investimet e brendshme me disa kufizime minimale.
- » Asnjë autorizim paraprak i posaçëm nuk është i nevojshëm për investime të huaja. Nuk ka kufizime sektoriale;
- » Investimet e huaja nuk mund të shpronësohen ose shtetëzohen direkt ose indirekt, me përjashtim të rasteve të veçanta kur kjo është në interes të publikut dhe sipas legjislacionit specifik;
- » Investitorët e huaj kanë të drejtë për të riatdhesuar të gjitha kapitalet dhe kontributet në natyrë;
- » Pavarësisht parashikimeve të legjislacionit vendas, në çdo rast investimet e huaja do të kenë një trajtim të barabartë dhe standardin më të lartë të mbrojtjes në përputhje me praktikatat e njohura ndërkombëtare.

Ndryshimet e vitit 2010 në *Ligjin nr. 7764 “Për*

*Investimet e Huaja”*¹⁸ zgjeruan garancitë e shtetit shqiptar për investitorët e huaj me garanci shtetëse, duke parashikuar mbrojtje të posaçme juridike për investitorët e huaj deri më 31 dhjetor 2014, që parashikonin të kryenin investime prej më shumë se 10 milionë euro dhe që përfshiheshin në konflikte gjyqësore me palë të treta private. Ligji nr. 7764 u bë sërish objekt i ndryshimeve gjatë vitit 2017 të cilat patën si objekt zgjatjen e afatit për mbrojtjen e posaçme shtetërore deri më 31 dhjetor 2018 dhe përfitimim të kësaj mbrojtje automatikisht edhe nga investitorët/investimet strategjike, procedurë e veçantë, që kanë marrë këtë status në përputhje me parashikimet e *Ligjit nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”*.

2. LIGJI NR.55/2015 “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE”

Në përpjekje për të rritur investimet në sektorët strategjikë u miratua ligji 55/2015 *“Për Investimet Strategjike”*. Ligji identifikon sektorët strategjikë të vendit (*Neni 8*)¹⁹ dhe parashikon procedurën të detajuar dhe të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtuese të mbështetjes dhe të shërbimeve ndaj investitorëve vendas dhe të huaj (*Neni 21 dhe Neni 22*). Në bazë të ligjit, *Ajencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)* është Sekretariati i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) i cili miraton statusin për çdo investitor strategjik dhe në të njëjtën kohë shërben si një dritare unike për investitorët e huaj në raport me institucionet shqiptare.

18 Ligji Nr.103 datë 16.09.2010 *“Për Disa Shtesa në Ligjin Nr.7764 datë 02.11.1993 “Për Investimet e Huaja”*

19 Energjia, bujqësia, turizmi, nafta dhe nxjerrja e burimeve natyrore janë sektorët strategjikë. Këta sektorë ofrojnë mundësi për të hyrë në fitimet afatgjata që vijnë nga investimi në një ekonomi me rritje të shpejtë dhe me kosto të ulët me burime natyrore mjaft të pashfrytëzuara dhe një forcë fleksibile punëtore.

17 Jo të gjitha vendet kanë një ligj të dedikuar për investimet/investitorët e huaj, p.sh. vende të ngjashme me Shqipërinë si Maqedonia dhe Irlanda nuk kanë një ligj të posaçëm. Lista e plotë e vendeve të cilat kanë/nuk kanë një ligj të posaçëm mund të gjendet në: <http://investmentpolicyhub.unctad.org/InvestmentLaws>”.

Procedurat administrative, të parashikuara nga ky ligj të cilat lidhen me përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik, si dhe me lëshimin e licencave/lejeve/autorizimeve dhe mendimeve, në zbatim të këtij ligji, janë me prioritet, renditen të parat në radhë dhe ndiqen me procedurë të përshpejtuar për të gjitha institucionet/entet/autoritetet publike, shtetërore, të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë në këto procedura.

Investitorët strategjikë mund të përfitojnë njërin prej 2 statuseve të mëposhtme:

1. Statusi *“Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”* duke përfituar shërbimet e mëposhtme:
 - » Kryerje e veprimeve përgatitore, përgatitje e dokumenteve dhe aplikim administrativ me procedurë të përshpejtuar nga agjenti asistues, përfshirë dokumentet e nevojshme që shoqërojnë aplikimin, kur ato lëshohen nga një organ i administratës shtetërore, me kërkesë të një organi tjetër të administratës shtetërore;
 - » Trajtim me prioritet të përgatitjes së dokumentacionit, dhënies së mendimeve apo ndjekjen e procedurave, të cilat përfshihen në fushën e veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore, të përfaqësuar në grupin operacional, për përgatitjen dhe realizimin e investimit strategjik;
 - » Konsolidim i tokës;
 - » Programe mbështetëse;
 - » Mbështetje me infrastrukturë ndihmëse;
 - » Vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Statusi *“Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”* garanton përveç shërbimeve

të mësipërme edhe sa vijon:

- » Shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, për të mundësuar zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;
- » Miratimin nga ana e Kuvendit, kur vlerësohet nga Këshilli i Ministrave, të kontratave përkatëse të investimit strategjik, me kërkesë të investitorit strategjik për të rritur sigurinë e marrëdhënies juridike të rregulluar përmes tij dhe shtetit shqiptar.

Në total nga KIS janë aprovuar 9 projekte të investimeve strategjike, nga të cilat 6 kanë përfituar statusin e investitorit strategjik/procedurë e asistuar dhe 3 statusin e investitorit strategjik/procedurë e veçantë. Që nga fillimi i vitit 2016 e deri tani, AIDA ka asistuar 30 projekte investimi, prej të cilave 17 kanë kaluar në të gjitha proceset e investimeve strategjike dhe janë trajtuar për vendimmarrje në Komitetin e Investimeve Strategjike (KIS). 8 projekte të tjera janë ende në fazë konsultimi/asistimi për përgatitje dokumentacioni dhe 5 projekte janë ende në faza të shprehjes së interesit. Nuk është evidentuar ndonjë dokument-vlerësimi lidhur me impaktin që ka patur miratimi i kuadrit ligjor të mësipërm.

3. UDHËRRËFYESI I POLITIKËS SË INVESTIMEVE TË QEVERISË SHQIPTARE²⁰

Udhërrëfyesi si dokument me karakter deklarativ, shpreh angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të krijuar një klimë të favorshme për investimet vendase dhe të huaja, duke identifikuar *parimet e politikave të mira të investimeve* të cilat duhet të përfshihen në legjislacionin përkatës të investimeve. Këto parime janë:

²⁰ Miratuar me VKM Nr. 579 datë 03.08.2016

- » *Sigurimi i mosdiskriminimit ndërmjet investitorëve vendas dhe të huaj.* Të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë investitorët/ investimet vendase dhe të huaja në lidhje me zgjerimin, operimin dhe mbrojtjen e investimeve të tyre, jo më pak të favorshëm se ato të siguruara në situata të ngjashme me investitorët vendas, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligje, rregullore dhe politika.
- » *Sigurimi i mbrojtjes efektive të pronësisë.* Të sigurojë pronën private dhe investimet nga shpronësimi apo nga masa me efekt të ngjashëm, me përjashtim të rasteve, kur shpronësimi kryhet për një qëllim publik, mbi bazë jodiskriminuese dhe si alternativë e fundit, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe parimet e ligjit ndërkombëtar dhe nëpërmjet pagesës së menjëhershme, të përshtatshme dhe efektive të kompensimit.
- » *Ndjekja e praktikave të mira rregullatore.* Të zbatohen mekanizma të efektshëm për menaxhimin e ankesave të investitorëve me qëllim forcimin e besimit, për të siguruar që

investimi të ruhet në kohë dhe të rritet transparenca rregullatore dhe administrative.

- » *Përdorimi i stimujve të planifikuar kur është e nevojshme dhe nxitjen e transparencës së plotë në dhënien e stimujve.*
- » *Garantimi i standardeve mjedisore dhe sociale.* Të sigurojë që të gjitha rregulloret për punën, shëndetin, sigurinë dhe mjedisin të zbatohen nga investitorët vendas dhe të huaj.
- » *Lehtësimin e hyrjes dhe qëndrimit të përkohshëm të personelit.* Të lehtësohet hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personelit të huaj teknik dhe drejtues, si dhe i familjeve të tyre, me qëllim angazhimin në aktivitete që lidhen me investimet e huaja.

Për realizimin e qëllimeve të mësipërme në udhërrëfyes është konsideruar mundësia e përgatitjes së një ligji të unifikuar për investimet²¹ së bashku me aktet ligjore përkatëse, përmirësimi i besimit të investitorëve duke krijuar mekanizma për ruajtjen, mbajtjen e investimeve dhe trajtimin e ankesave të tyre (*grievance mechanisms*) dhe përmirësimi i kuadrit institucional.

²¹ Nuk ka një praktikë të konsoliduar ndërkombëtare lidhur me natyrën e ligjeve të investimeve, nëse duhet të jetë ligj kuadër që trajton vetëm parimet dhe garancitë e përgjithshme për investitorët, duke i lënë hapësirë veprimi Qeverisë për të detajuar më tej këto parime me akte nënligjore, apo një ligj i detajuar i cili në mënyrë të hollësishme të trajtojë edhe nga ana procedurale aspekte të ndryshme që lidhen me veprimtaritë e investitorëve. Zgjedhja e njërit apo tjetrit model është në varësi të objektivave që synohen të realizohen me një ligj të tillë dhe në varësi të problematikave që një ligj i tillë synon të zgjidhë.

Problematikat më kryesore të evidentuara nga diskutimet mbi kuadrin ligjor në fushën e investimeve²²

Nga procesi i konsultimeve mbi harmonizimin e kuadrit ligjor në fushën e investimeve disa nga komentet dhe çështjet më kryesore që sugjerohet të mbahen në konsideratë nga institucionet politike-bërëse lidhen me:

- a) **Qartësimin e objektivave strategjike dhe politikave kombëtare që orientojnë investimet**
- » Investitorët, pavarësisht se marrin rreziqe në këmbim të fitimit, e konsiderojnë qëndrueshmërinë dhe qartësinë e prioriteteve

strategjike, si një nga nxitësit kryesore në vendimmarrje. Kështu nga konsultimet rezulton se bizneset kërkojnë një vëmendje të qëndrueshme dhe të qartë ndaj politikave ekonomike tek sektorët/aktivitetet (p.sh. shërbimet) që janë në koherencë me avantazhet konkurruese të Shqipërisë (p.sh. krahu i lirë i punës).

- » Orientimi i investimeve publike në funksion të konkurrueshmërisë duke përmirësuar infrastrukturën, institucionet dhe shërbimet ndaj biznesit do të forconte ndikimin e reformave legjislativë në klimën e investimeve.
- » Qartësia e objektivit të reformave strukturore, nëse do i jepet prioritet modelit të biznesit të vogël e të mesëm apo do të mendohet

²² Problematikat e përfshira janë një përmbledhje e analizave të mëparshme të Sekretariatit, komenteve të bizneseve dhe institucioneve, si edhe sintezë e diskutimeve të takimit konsultativ të datës 23 Maj 2018.

për një rritje të strukturës ekonomike drejt bizneseve të mëdha mbetet një mesazh mbi politikën ekonomike që duhet qartësuar më tej për biznesin.

- b) **Administrata dhe Institucionet**
- » Ridimensionimi i administratës që të garantojë zbatimin e përgjegjshëm dhe efektiv të parimeve të sanksionuara në ligje;
 - » Institucionet mbështetëse të investitorëve dhe strukturat përgjegjëse për trajtimin e ankesave të tyre.
- c) **Aksesi, transparenca dhe vlerësimi i impaktit të incentivave në investime.**

Më konkretisht:

Kuadër i ri ligjor për investimet apo kuadër ekzistues?

Vlerësohet përgatitja e një ligji të ri. Një ligj i ri i investimeve mund të shërbejë për të nxitur administratën drejt një vullneti më pozitiv kundrejt investitorëve dhe një pikënisje të re. Një ligj i ri i investimeve është mirë që të ekzistojë, por një ligj i vetëm nuk mund të zgjidhë të gjitha problematikat. Duhet edhe një analizë paraprake e ecures së ligjit të investimeve strategjike, për të analizuar çfarë nuk ka funksionuar përpara se të bëhet një ndryshim ligjor i caktuar. Më tepër se ligji i investimeve, legjislati në tërësi për biznesin ka probleme dhe duhet rishikuar në raport me legjislatin sektorial.

IGM në kuadrin e ligjit të investimeve - alternativë për zgjidhjen mosmarrëveshjeve investitor-institucione shtetërore.

IGM konsiderohet si një mekanizëm interesant. Propozimi për parashikimin e tij në ligj do t'i jepte një shtysë institucionale zgjidhjes së ankesave të investitorëve që në fazën paraprake, për të evituar që investitorët të drejtohen për zgjidhje tek ambasada

dorë të shtetit të tyre apo drejtpërdrejt tek Kryeministri. Pavarësisht se p.sh. kontratat koncesionare kanë parashikime ligjore mbi mënyrat e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve midis investitorëve dhe shtetit parashikimi në ligj do të shërbente si një alternativë shtesë për palët.

IGM instrument për zgjidhje sistematike të problematikave të investitorëve – sfida për institucionet dhe administratën

Një IGM do të shërbente si një instrument frenues i veprimtarisë abuzive të administratës. Nga ana tjetër do të shërbente për ndërgjegjësimin e saj në drejtim të zbatimit të duhur të parashikimeve ligjore sipas vullnetit të ligjvënës, në funksion të arritjes së qëllimit për mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe krijimin e një klime biznesi më të favorshme. IGM evidenton **problematikat sistematike** dhe orienton vendimmarrjen drejt **zgjidhjeve sistematike**. Akoma administrata perceptohet se ka një ndërgjegjësim të ulët sa i takon veprimet apo mosveprimeve të saj si faktor në tërheqjen apo largimin e investitorëve. Pranohet se një mekanizëm i tillë i shoqëruar edhe me një ndërgjegjësim më të madh të administratës mbi rolin e saj do të sjellë përfitime të dyanshme, si për investitorët, ashtu edhe për administratën duke minimizuar kostot e ndërsjellta në rastet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në juridiksionin gjyqësor apo në arbitrazhin ndërkombëtar.

Mungesa e instrumentave të vetëkorrigjimit në dispozicion të administratës dhe vullneti institucional. Pretendohet se ka një problematikë ligjore që lidhet me mënyrën si administrata publike mund të vetëkorrigjohet në rastin kur ndërmerr veprime me anën e akteve administrative të gabuara ose mosveprime. Kjo çështje duhet të konsiderohet rast pas rasti, por administrata nga pikëpamja ligjore ka mundësinë për të shfrytëzuar institutet e

revokimit/shfuqizimit sikurse parashikohet nga Kodi i Procedurave Administrative. Disa komente sugjerojnë se problemi i mungesës së vetëkorrigjimit nga ana e administratës nuk vjen nga mungesa e instrumentave ligjore, por nga mungesa shpeshherë e vullnetit institucional për gjetjen e zgjidhjeve në rastin e konflikteve.

Procedura e IGM duhet të jetë e detajuar dhe transparente

Nëse do të parashikohet një mekanizëm i mirëfilltë IGM, sugjerohet që procedura të jetë e detajuar, ku të përcaktohen qartë roli i çdo hallke administrative për trajtimin e ankesave dhe transparente për të gjithë aktorët e përfshirë. Për këtë arsye kuadri nënligjor duhet të jetë i detajuar dhe i qartë dhe të mos lejojë hapësirë për interpretime të gabuara.

Institucionalizimi i modelit të IGM – kujdes me mbivendosjet institucionale

Nëse ligji për investimet do të parashikojë një model IGM duhet të jetë shumë e qartë institucioni që do të ushtrojë një funksion të tillë, për të mos krijuar mbivendosje me institucione ekzistuese si p.sh. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS). Aktualisht ka një mekanizëm

IGM që është MSHMS e cila ka krijuar tashmë një eksperiencë mbi problematikat e paraqitura nga ana e biznesit duke përgatitur një bazë të dhënash e cila më pas do të shërbejë për të bërë analizat e nevojshme për ndërhyrjet përkatëse. Ka sugjerime që IGM mund të jetë në kuadër të AIDA si një institucion i cili merret me promovimin dhe pjesë e shërbimeve të kujdesit (aftercare) ndaj investitorëve. Disa aktorë vlerësojnë se IGM mund të krijojë në praktikë një mbivendosje me hallkat e ankimit administrativ të cilat ekzistojnë aktualisht. Nuk është problemi nëse ekzistojnë apo jo këto mekanizma, por sa efektive dhe të zbatueshme janë ato.

Rritje e transparencës dhe aksesit mbi incentivat konkrete

Në legjislacionin aktual mungojnë incentivat konkrete të cilat të jenë lehtësisht të zbatueshme në dispozicion të investitorëve dhe pa procedura burokratike administrative. Për shembull, është e vështirë të gjendet informacion i plotë për investitorët se në cilat pronat publike mund të investojnë. Këto të fundit nuk janë në treg dhe nuk janë transparente. Gjithashtu, sugjerohet p.sh. të konsiderohet zbatimi i parimit të miratimit në heshtje në rastin e procedurave administrative apo lejeve që kanë lidhje me një investim të ri.

Mbi disa modele të mekanizmit të trajtimit të ankesave të investitorëve në vende të ndryshme²³

Në kuadrin e procesit të konsultimit për përmirësimin e kuadrit ligjor, u përgatit edhe një vështrim krahasues, mbi disa modele të mekanizmave IGM sipas kuptimit klasik apo të ngjashëm me to në 6 vende me karakteristika të ndryshme.

Kështu nga kjo analizë shkurtimisht rezultojnë:

1. Qëllimi i ngritjes së mekanizmave të tillë është dhënia e garancive ligjore për zbatimin e shtetit ligjor, zbatimit të parimit të parashikueshmërisë dhe të mundësisë efektive që kanë investitorët për të vënë në vend të drejtat e shkeluar apo të mohuara nga ana e administratës.
2. Aspektet pozitive të IGM mund të përmbledhen si më poshtë:
 - » Alternativë e thjeshtë, e shpejtë dhe pa kosto shtesë e zgjidhjes së ankesave të investitorëve;
 - » Mundësi për institucionin e ngarkuar me

IGM të kuptojë më mirë problematikat e bizneseve dhe për të promovuar në të njëjtën kohë shërbimet e institucioneve në funksion të lehtësimit të klimës së investimeve;

- » Ekzistenca e një IGM i shërben institucioneve për të patur një ide me të qartë mbi problemet sistematike dhe për zgjidhjen po sistematike të tyre.
 - » Garanton një përgjigje të shpejtë lidhur me ankesën e investitorit pa procedura burokratike.
3. Maqedonia dhe Kroacia nuk kanë një model të mirëfilltë të IGM sepse nuk kanë një ligj të veçantë për investimet/investimet e huaja.
 4. Serbia ka një model IGM që përshkruhet kryesisht në mënyrë deklarative në ligjin përkatës për investime si garanci e përgjithshme për investitorët, por nuk është e qartë mënyra e trajtimit të ankesave, cilat ankesa mund të paraqiten apo afati i shqyrtimit të tyre.
 5. Greqia paraqet një model interesant të *Business Ombudsman* të përshtatur nga viti 2013

në kuadër të *Enterprise Greece* (Agjencia e Promovimit të Investimeve) me fokus jo zgjidhjen e çështjeve dhe ankesave si pjesë e ankimit administrativ, por në funksion të ndërmjetësimit për zgjidhjen e ankesave në fazën e tyre paraprake. Juridiksioni i *Business Ombudsman* është i kufizuar vetëm sa i takon ankesave që lidhen me procedurat e licencimit të investitorëve.

6. Ukraina ofron një model të veçantë “*suigeneris*” të trajtimit të ankesave të investitorëve, që mund të vihen në funksion vetëm pas shterimit të të paktën një procedure të ankimit administrativ. Më tepër se një model IGM në

kuptimin klasik, *Business Council Ombudsman* është i ngjashëm më tepër me një institucion si Avokati i Popullit në Shqipëri.

7. Në Gjeorgji funksionon *Georgia Business Ombudsman* si një institucion i veçantë dhe jo si IGM. Ky institucion trajton ankesat e bizneseve që lidhen kryesisht me tatimet dhe taksat dhe procedurat përkatëse, i ngjashëm me Avokatin e Tatimpaguesve në Shqipëri. *Georgia Business Ombudsman* është themeluar në vitin 2015 dhe ka zëvendësuar institucionin e Avokatit të Tatimpaguesit (*Tax Ombudsman*) në funksion deri në 2011.

HAPAT NË VIJIM

Investimet e huaja direkte (IHD) përbëjnë tashmë një element strukturor për ekonominë shqiptare. Ndaj është mjaft e rëndësishme të përmirësohet kuadri ligjor dhe të përshtatet me zhvillimet rajonale dhe praktikatat më të mira bashkëkohore. Ndërkohë zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga kontratat me investitorët është një element mjaft i rëndësishëm për të rritur besueshmërinë dhe interesin e investitorëve për vendin.

Për këtë qëllim sugjerohet një vendimarrje nga të gjithë aktorët e përfshirë në lidhje me shtyllat e mëposhtme:

- a) ***Një kuadër bashkëkohor ligjor i unifikuar dhe harmonizuar me ligjet sektoriale të investimeve, si një instrument nxitës për një “motivim të ri për investitorët”²⁴***

Një ligj i unifikuar në fushën e investimeve mund të sillte një imazh të ri për vendin nëpërmjet ofrimit të një ligji më të fortë, përputhshmëri më të gjerë me politikatat rajonale dhe me parashikimet në kuadrin e BIT. Por në çdo rast, politikëbërja duhet të ketë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe për të maturuar një zgjidhje të përshtatshme për një ligj të ri të unifikuar ose jo në fushën e investimeve.

Paketa e ligjeve kryesore për investimet (Ligji nr.

7764, Ligji nr.55/2012 dhe Ligji nr. 9789) dhe e akteve nënligjore është ambicioze, serioze dhe me objektiva strategjike. Pavarësisht nga kjo për shkak të dinamikave që ka patur në rrafshin ndërkombëtar lidhur me praktikatat e mira në fushën e investimeve²⁵, si edhe të kohës së gjatë që prej miratimit të Ligjit bazë nr. 7764 “Për Investimet e Huaja”, ky i fundit mund të jetë objekt i përmirësimeve të mëtejshme në lidhje me:

- » Parashikimin e garancive edhe për investitorët vendas;
 - » Parashikimin e përkufizimeve shtesë që mungojnë si p.sh. investimet direkte;
 - » Parashikimin më të plotë të lirisë për të investuar dhe të detyrimeve të investitorëve;
 - » Parashikimin e një mekanizmi të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis investitorëve dhe agjencive shtetërore që në fazat paraprake duke shmangur konfliktet ligjore (administrative dhe/ose gjyqësore).
 - » Parashikimin më të qartë të parimit të mosdiskriminimit ndërmjet investitorëve të huaj.
- b) ***Vizioni i Qeverisë mbi politikatat e investimeve kushtëzohet nga mirëfunksionimi i institucioneve të qëndrueshme dhe të besueshme***

24 Këtu janë përfshirë edhe pikëpamjet e grupit të ekspertëve të IFC sipas prezantimit PPT - Slide 11 dhe vijues.

25 Kjo do të ishte në linjë edhe me rekomandimet e UNCTAD 2017 në kuadër të “UNCTAD Policy Review for the Region” dhe MAP REA për 6 Western Balkans countries.

Kuadri ligjor në fushën e investimeve duhet mbështetur nga institucione dhe një administratë që ka mentalitetin e duhur. Vizioni i qeverisë për klimën e investimeve duhet të ndahet dhe të mbështetet nga të gjitha institucionet dhe administrata. Çështjet e investitorëve nuk duhet të konsiderohen problem vetëm i një ministrie apo sektori, por i të gjithë administratës. Kjo e fundit duhet të mbështesë vizionin për një klimë më të mirë investimesh, duke u ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e investimeve veçanërisht atyre të reja dhe impaktin e tyre në ekonomi, si dhe duhet të garantojë përgatitjen e një kuadri nënligjor të përshtatshëm dhe të zbatueshëm.

c) IGM - mekanizëm për evidentimin e problemeve sistemike mbi ndërgjegjësimin e palëve dhe gjetjen e zgjidhjeve të dyanshme pa kosto

Theksojmë se nuk ka ende një praktikë të konsoliduar ndërkombëtare lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtyre mekanizmave, si edhe mbi kompetencat apo natyrën e institucionit përkatës të ngarkuar me këtë rol ndërmjetësimi. Ndërkohë, trajtimi i ankësave të investitorëve lidhur me veprimet apo mosveprimet e administratës publike ka një rëndësi parësore për të parandaluar konfliktet ligjore të cilat mund të kalojnë në juridiksionin administrativ, gjyqësor apo në sferën e arbitrazhit ndërkombëtar. Mekanizma të tillë ekonomizojnë nga pikëpamja e kohës dhe e kostove gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme në një fazë ndërmjetësimi.

Këto mekanizma shikohen si pjesë e shërbimit të kujdesit (*aftercare*) të kryera nga agjencitë e promovimit të investimeve apo institucione të tjera të cilat ngrihen për qëllime të ndërmjetësimit të konflikteve midis investitorëve (biznesit) dhe administratës publike.

Përgatitja e një modeli të caktuar lidhet me kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi në një vend të caktuar si edhe mbi problematikat që synohen të zgjidhen nëpërmjet zbatimit të një mekanizmi të tillë, duke mbetur kështu në varësi të vendimmarrjes së Qeverisë.

d) Aksesit dhe informacionit mbi incentivat duhet të monitorohen

Incentivat e investimeve konsiderohen avantazhe të matshme ekonomike që qeveritë u ofrojnë sipërmarrjeve të caktuara apo grupeve të sipërmarrjeve, me qëllim që të orientojnë investimet në sektorë apo rajone të caktuara ose për të ndikuar në natyrën e këtyre investimeve. Këto përfitime mund të jenë fiskale (si lehtësim tak-sash) ose jo-fiskale (si grante, hua ose lehtësira rregullatore për të mbështetur zhvillimin e biznesit ose rritur konkurrueshmërinë)²⁶.

Incentivat janë parashikuar kryesisht në nivel sektorial (p.sh. 6% TVSH për strukturat akomodeuese në turizëm apo subjektet e certifikuara në agriturizëm), në varësi të pritshmërive të qeverisë mbi impaktin e tyre social dhe ekonomik. Incentivat në nivel rregullator dhe në reduktimin e kostove administrative janë parashikuar kryesisht në ligjin për investimet strategjike, ndërsa një grup tjetër incentivash fiskale dhe jo fiskale janë parashikuar për nxitjen e zhvillimit në TEDA. Incentivat në çdo rast duhet të jenë të matshme dhe lehtësisht të zbatueshme dhe të aksesueshme nga investitorët. Sugjerohet që incentivat të jenë të qëndrueshme dhe të garantojnë konkurrencë të ndershme duke garantuar parashikueshmëri për investitorët. Sipas investitorëve një administratë e shpejtë dhe e përgjegjshme është incentiva më e mirë.

²⁶ Sebastian James, September 2013, "Tax and Non-Tax Incentives and Investments: Evidence and Policy Implications", Investment Climate Advisory Service of the World Bank

SHTOJCA 1

RIRA - Kuadri i Politikave dhe Veprimet e Reformës²⁷

Fusha e Politikave	Tema e Reformës	Veprimet e Reformës
I. Hyrja & Krijimi i investimeve	<i>1. Përmirësimi i hyrjes dhe krijimi i mundësive për investitorët</i>	1.1 Rishikimi i ligjeve dhe rregulloreve të brendshme në BP6 për mospërputhje në lidhje me parimet e mos-diskriminimit për hyrjen në treg dhe themelimin e biznesit (Entry Gap Analysis) dhe publikimi i një liste të konsoliduar të pengesave ligjore për hyrjen në treg për të rritur transparencën për investitorët. 1.2 Përdorimi i sa më sipër për të informuar debatin mbi pengesat ekzistuese për investime në rajonin e BP6.
	<i>2. Përmirësimi i politikave dhe procedurave për krijimin e bizneseve</i>	2.1 Mbështetje për zhvillimin e një portali për të ofruar dhe krahasuar informacionin mbi procedurat për themelimin dhe operimin e një biznesi në rajon bazuar mbi bashkëpunimin tashmë ekzistues të agjencive të rajonit për regjistrimin e biznesit. 2.2 Krahasimi, rishikimi dhe njëjtësimi, aty ku është e mundur i kërkesave të biznesit për regjistrim në nivel rajonal. 2.3 Lehtësimi dhe përsheptimi i lejeve të punës dhe procedurave përkatëse në nivel ekonomie.

²⁷ <https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2018/06/RIRA-final-11-May-2018.pdf>

II. Mbrojtja & Ruajtja e Investimeve	3. Harmonizimi i kornizave ligjore për investime, përfshirë IIAs, me përvojat më të mira ndërkombëtare dhe standardet e BE	3.1 Ndërmarrja e një listimi të detajuar dhe analize të thelluar krahasimore të marrëveshjeve ndërkombëtare të BP6 (IIA)²⁸, me fokus të veçantë në BIT, duke i krahasuar ato me gjeneratën e re të IIA për të përmirësuar përafrimin me standardet e orientuara ndaj reformave në gjenerata të reja të IIA/standarde të BE²⁹. 3.2 Kryerja e një analize mbi mangësitë e legjislacionit të ekonomive mbi investime specifike vendase me IIA-të e tyre dhe gjeneratën e re të IIA, bazuar në një analizë të përgjithshme të kuadrit gjithëpërfshirës ligjor të ekonomive, i cili do të zbatohet pas miratimit të axhendës rajonale të reformës së investimeve. 3.3 Përmirësimi i legjislacioneve të brendshme në përputhje me standardet e ofruara në gjeneratën e re të IIA. 3.4 Forcimi i mandatit të Grupit të Përbashkët të Punës SEEIC-CEFTA mbi Investimet për ta ngritur si një mekanizëm për shkëmbimin rajonal të standardeve të IAA-ve, modernizimin e IIA-ve dhe nëse konsiderohet e nevojshme nga ekonomitë pjesëmarrëse për të mundësuar zhvillimin e një qasje strategjike për negociimin/rishikimin e IAA-ve.
	4. Forcimi i mekanizmave për ruajtjen e investimeve në rajon	4.1 Përmirësimi i mekanizmave për trajtimin e ankesave të investitorëve në ekonomitë që kanë interes, duke marrë parasysh nivelet e ndryshme të zhvillimit dhe mbështetjes së nevojshme për rritje të kapaciteteve. 4.2 Forcimi i mandatit të Grupit të Përbashkët të Punës SEEIC-CEFTA për të krijuar një platformë rajonale për shkëmbimin e përvojave në menaxhimin e ankesave dhe parandalimin e ankesave të investimeve.

28 Në mënyrë kolektive, çdo marrëveshje ndërkombëtare e cila rregullon investimet quhet një marrëveshje ndërkombëtare investimesh (IIA). Angazhimet ndërkombëtare të investimeve janë përcaktuar në traktate, qoftë dypalëshe, apo në marrëveshje rajonale ose shumëpalëshe. Disa traktate merren vetëm me investime të huaja (zakonisht referuar si traktate dypalëshe të investimeve, ose “BIT”). Të tjera traktate trajtojnë investimet së bashku me çështje të tjera të lidhura, si p.sh. me tregtinë, prokurimet qeveritare, konkurrencën dhe pronësinë intelektuale (marrëveshje preferenciale apo të tregtisë së lirë, ndryshe “PTA”). Gjithashtu, ka disa marrëveshje shumëpalëshe të cilat ofrojnë mbrojtje të veçantë në sektorin e energjisë (“Traktati i Energjisë”) apo që sigurojnë akses në organe të dedikuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (Marrëveshja ICSID). Gjithashtu, shumë instrumente ligjore, përfshirë për shembull traktatet për tatimin e dyfishtë (DTT).

29 Marrëveshja CEFTA nuk do të ndikohet nga ky veprim i reformës.

III. Tërheqja & Nxitja e Investimeve ³⁰	5. Zhvillimi i një iniciative rajonale për nxitjen e investimeve	5.1 Krijimi i një kuadri rajonal për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit në mesin e ndërmjetësuesve individual për nxitjen e ekonomive të investimeve (IPI) apo agjencive (IPA), duke konsideruar opsionin për krijimin e një njësie koordinimi nën ombrellën e strukturave rajonale. 5.2 Mbështetje për zhvillimin e një portali rajonal për investimet mbi kërkesat rregullatore dhe mundësitë e investimeve në rajon, për t’u ndërtuar mbi portalet ekzistuese rajonale mbi investimet, si për shembull Forumi i Dhomave të BP6 dhe të tjera, aty ku mund të jetë e nevojshme. 5.3 Mbështetje për ndërmjetësuesit individualë ekonomikë për nxitjen e investimeve për të kontribuar në mënyrë efektive në iniciativën rajonale për nxitjen e investimeve. 5.4 Ndërmarrja e një analize të thelluar të sektorit për të identifikuar sektorët dhe propozimet inovatore (<i>value propositions</i>) për nxitjen rajonale të investimeve, me lidhje të qartë horizontale me shtyllën MAP REA mbi specializimin inteligjent.
	6. Përmirësimi i incentivave dhe i transparencës & qeverisjes së tyre	6.1 Zbatimi i standardeve dhe parimeve për incentivat që kanë të bëjnë me transparencën, qeverisjen dhe parashikueshmërinë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i para-aderimit në BE (kapitulli mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore). 6.2 Përmirësimi i aksesit në informacionin mbi incentivat duke publikuar inventarë në shkallë ekonomie që centralizojnë klauzolat kryesore dhe të dhënat që kanë të bëjnë me këto instrumente. 6.3 Angazhimi për të mësuar nga vendet e tjera mbi metodologjitë për vlerësimin kosto-përfitim dhe përvojat mbi qeverisjen dhe administrimin e incentivave në kuadër të Grupit të Përbashkët të Punës SEEIC-CEFTA mbi Investimet. 6.4 Angazhimi sistematik për vlerësimin dhe monitorimin e incentivave për të matur efikasitetin dhe vlerësimet kosto-përfitim në shkallë ekonomie.

30 Mundësitë për t’iu bashkuar financimit të WBIF (EIF) do të shqyrtohen për veprimet e reformës mbi nxitjen e investimeve aty ku është e mundur dhe konsideruar e përshtatshme.

SHTOJCA 2

Modele të Mekanizmave për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investitorëve (IGM)

	MAQEDONIA ³¹	SERBIA ³²
KUADRI LIGJOR-INSTITUCIONET	Nuk ka një ligj specifik për investimet e huaja. Kuadri ligjor është i përbërë nga ligje të vecanta, ku më i rëndësishmi është <i>Ligji "Për Shoqëritë Tregtare"</i> (2004). Institucioni që merret me promovimin e mundësive për investime është Invest Macedonia-Agjenci e Qeverisë së Maqedonisë. Nuk ka një mekanizëm të mirëfilltë për IGM.	<i>Ligji Nr. 89/2015 "Për Investimet"</i> (investimet e huaja + investimet vendase) (Neni 3/2). Agjencia për Zhvillim e Serbisë (në varësi të Ministrisë së Ekonomisë) është institucioni që trajton ankesat e investitoreve (Neni 18/1) në lidhje me punën e institucioneve.
OBJEKTIVI	N/A	Agjencia nuk ka në objektivat dhe detyrat e veta specifike trajtimin e ankesave të investitorëve, pavarësisht se në mënyrë deklarative ligji parashikon trajtimin e problematikave të tyre në kuadrin e shërbimeve <i>aftercare</i> . Agjencia është themeluar për të kryer aktivitete zhvillimore, ekspertize dhe operacionale për nxitjen dhe zbatimin e investimeve direkte, promovimin dhe rritjen e eksporteve, zhvillimin dhe përmirësimin e konkurrencës së kompanive, rritjen e reputacionit dhe zhvillimin e Republikës së Serbisë në fushën e ekonomisë dhe zhvillimit rajonal (Neni 27).

31 <http://www.investinmacedonia.com/>

32 <http://ras.gov.rs/en>

KUADRI LIGJOR PËR INVESTIMET, DEBATET DHE SFIDAT

FUSHA E KOMPETENCEVE	N/A	Fusha e kompetencave të Agjencisë në lidhje me mënyrën e trajtimit të ankesave dhe tipologjinë e ankesave që mund të trajtojë nuk është qartësisht e përcaktuar. Agjencia ka kompetencë të investigojë menjëherë në lidhje me ankesat e investitorëve dhe duhet të informojë ata në lidhje me veprimet e ndërmarra brenda 15 ditëve nga dita e paraqitjes së ankesës. (<i>Agjencia për Zhvillim e Serbisë duhet menjëherë pas marrjes së ankesës, të hetojë përmbajtjen e ankesës dhe të marrë masa brenda juridiksionit të saj për të eliminuar ankesat kundër punës së autoriteteve publike - Neni 18/2</i>). Parashikohet vetëm në mënyrë deklarative se institucionet qeveritare duhet të trajtojnë me urgjencë të drejtat e investitorëve në lidhje me realizimin dhe mbështetjen e investimit (<i>Neni 16/2</i>) dhe vetëm nëse kjo nuk ndodh vendoset në lëvizje Agjencia në bazë të ankesës së investitorit.
ÇËSHTJET QE NUK TRAJTON	N/A	1. Ankesa që lidhen me çështje në fushën e kompetencave të Bankës Kombëtare të Serbisë (themelimi dhe funksionimi i bankave dhe institucioneve të tjera financiare); 2. Ankesa për çështje në fushën e kompetencave të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Neni 18)
	KROACIA³³	GREQIA³⁴
KUADRI LIGJOR - INSTITUCIONET	Nuk ka një ligj specifik për investimet e huaja. Ligji për Shoqëritë Tregtare përcakton formën juridike të organizimit të investitoreve vendas dhe të huaj. Institucioni që merret me promovimin e mundësive për investime është Agjencia për Investime dhe Konkurrueshmëri - agjenci e Qeverisë së Kroacisë. Nuk ka një mekanizëm të mirëfilltë IGM.	Kuadri ligjor për investimet në Greqi mbështetet në 2 ligje kryesore: Ligji i ri për Investime 4399/2016 që adreson çështjet për investimet në shkallë të vogël dhe Ligji 4146/2013 që adreson çështjet në lidhje me investimet strategjike. <i>Enterprise Greece</i> është agjencia që vepron nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizmit për të tërhequr investime në Greqi. Ka një model të mirëfilltë për trajtimin e ankesave të investitoreve. Në prill 2013, u miratua Ligji 4146/2013 "Krijimi i një mjedisi miqësor për zhvillim për investime strategjike dhe private". Ky ligj krijoi Ombudsmanin e Investitorit si strukturë brenda <i>Enterprise Greece</i> . Promovohet si strukturë e mbështetur fort nga Qeveria dhe rekomandimet/sugjerimet e tij zbatohen nga institucionet përkatëse. Modeli <i>Investor Ombudsman</i> që ofron Greqia është i ngjashëm me atë të zbatueshëm në Korenë e Jugut (<i>Foreign Investment Ombudsman</i> (OFIO); dhe <i>Investment Ombudsman</i> (Filipine dhe Kazakistan)
OBJEKTIVI	Nuk ka në objektivat e veta specifike trajtimin e ankesave të investitorëve. Agjencia ka qëllim t'u ofrojë investitorëve shërbime të plota për zbatimin e projekteve investuese, të propozojë masa për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe për të promovuar Kroacinë si një destinacion investimi i dëshirueshëm.	Investor Ombudsman vepron si ndërmjetës për investitorin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve specifike ose vështirësive të tjera që lindin në çdo fazë të procedurës së licencimit dhe për tejkalimin e rasteve të veçanta të vonesave në zbatimin e projekteve të investimeve. Investitori që has pengesa për aspekte që lidhen me procedurat e licencimit pritet nga <i>Investor Ombudsman</i> . Një <i>account manager</i> regjistron ankesën dhe problematikën e investitorit të hasura gjatë procedurës së licencimit dhe identifikon ato dokumente që janë vendimtare për shpjegimin e shkaqeve kryesore të vonesës dhe faktorët kryesorë që ndikojnë negativisht në zbatimin e projekteve specifike të investimeve. <i>Investor Ombudsman</i> shqyrton tiparet e veçanta të secilit rast individual dhe bashkëpunon me autoritetet kompetente për të përshpejtuar zgjidhjen e çështjeve komplekse. Ndërmjetëson në emër të investitorit gjatë procedurës së licencimit, duke synuar zgjidhjen e pengesave burokratike, vonesave, mosmarrëveshjeve ose vështirësive të tjera që lidhen me shërbimet shtetërore. Duhet të theksohet se <i>Investor Ombudsman</i> gëzon mbështetje të fuqishme politike dhe për rrjedhojë, ka provuar të jetë një institucion shumë efektiv.

33 <http://www.ficc.hr/objectives/>

34 <https://www.enterprisegreece.gov.gr/en/invest-in-greece/ombudsman>

FUSHA E KOM-PETENCAVE	N/A	a) Projektet e investimeve private, prej 2.000.000 euro ose më shumë, të cilat ballafaqohen me vonesa, mosmarrëveshje apo vështirësi të tjera që dalin gjatë çdo fazë të procedurës së licencimit. b) <i>Investor Ombudsman</i> vepron si ndërmjetës statutor për investitorin me qëllim të zgjidhjes së çështjeve komplekse që dalin gjatë procedurës së licencimit tek autoritetet kompetente të licencimit. c) <i>Investor Ombudsman</i> identifikon çështjet kyçe të hasura nga investitorët gjatë procedurës së licencimit dhe i paraqet institucioneve vendimmarrëse propozime konkrete për përmirësime ligjore.
ÇËSHTJET QË NUK TRAJTON	N/A	a) Rastet që aktualisht janë për shqyrtim përpara gjykatave kompetente ose ato të gjykuara prej tyre. b) <i>Investor Ombudsman</i> nuk merret me ankesat lidhur me çështjet e transparencës ndaj autoriteteve publike, por mund të ofrojë informacion të përgjithshëm. c) <i>Investor Ombudsman</i> nuk ndërhyr në asnjë lloj mosmarrëveshje ndërmjet palëve private.

	UKRAINA ³⁵	GJEORGJIA ³⁶
KUADRI LIGJOR - INSTITUCIONET	Kuadri ligjor për investimet në Ukrainë përbëhet nga disa ligje ku më kryesoret janë: a) Ligji “Mbi Aktivitetin e Investimeve” (1991) i cili përcakton parimet e përgjithshme për investime; b) Ligji “Për mbrojtjen e investimeve të huaja” (1991); c) Ligji “Për regjimin e investimeve të huaja” (1996). Nuk ka një mekanizëm të mirëfilltë të dedikuar IGM. Ukraina ka specifikë sepse ka një institucion <i>Business Ombudsman Council</i> i krijuar në 2014 (institucion “sui generis”) me vendim të Qeverisë së Ukrainës dhe në vijim të një Memorandumi Bashkëpunimi “Iniciativa Kundër Korrupsionit” të nënshkruar midis Qeverisë së Ukrainës, BERZH dhe OECD, Dhomave të Tregtisë dhe Sindikatave. Nuk është një institucion ekskluzivisht për zgjidhjen e ankesave të investitoreve në kuptimin klasik të IGM.	Kuadri ligjor për investimet përbëhet nga dy ligje: a) Ligji për Promovimin Shtetëror dhe Garancitë për Investime (12 nëntor 1996); b) Ligji për Promovimin Shtetëror dhe Incentivat (30 qershor 2006). <i>Invest in Georgia</i> - Agjencia Kombëtare e Investimeve në Gjeorgji është agjenci qeveritare e cila promovon mundësitë e investimit në Gjeorgji dhe shërben si ndërmjetëse/lehtësuese për komunikimin e investitorëve me institucionet e administratës.
OBJEKTIVI	<i>Business Council Ombudsman</i> (BCO) është një strukturë këshilluese e Qeverisë së Ukrainës e cila ka objekt transparencën e veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe vendore me objektiv parandalimin e korrupsionit dhe/ose shkeljeve të tjera të interesave legjitime të bizneseve. BCO përbëhet nga: a) Business Ombudsman; b) Dy Zv/ Ombudsman; c) Sekretariati.	Agjencia ndryshon nga <i>Georgia Business Ombudsman</i>. <i>Georgia Business Ombudsman</i> është një institucion i veçantë dhe jo IGM, por institucion në dispozicion të bizneseve në përgjithësi dhe me fokus kryesisht në çështjet e taksave. Business Ombudsman është themeluar në vitin 2015 dhe ka zëvendësuar institucionin e Avokatit të Tatimpaguesit (<i>Tax Ombudsman</i>) në funksion deri në 2011. Business Ombudsman emërohet nga Kryeministri me miratimin e Kryetarit të Parlamentit. Business Ombudsman mbikëqyr mbrojtjen e të drejtave dhe legjitimeve të lidhura me aktivitetet sipërmarrëse (nuk ka një përcaktim të qartë se cilat përfshihen në këto aktivitete) nga shkeljet e një organi administrativ. Business Ombudsman: a) Shqyrton ankesat e veçanta ose në grup të paraqitura për shkeljet nga organet administrative gjatë aktivitetit sipërmarrës; b) zbulon dhe identifikon gabimet në legjislacion dhe në praktikë; c) zhvillon veprimtari me karakter konsultativ dhe informues. Business Ombudsman përgatit rekomandime për organin administrativ për vënien në vend të të drejtave të subjekteve, në rastet e verifikimit të shkeljeve (<i>Neni 6</i>).

35 <https://boi.org.ua/en/about/legal-acts>
36 <http://businessombudsman.ge/files/laws/Laë%20on%20Business%20Ombudsman%20-%20ENG.pdf>
<http://businessombudsman.ge/en/about-us/the-office-of-the-business-ombudsman-of-georgia>

FUSHA E KOM-PETENCAVE	Çdo person fizik ose juridik i cili kryen biznes në Ukrainë mund të regjistrojë një ankesë pranë BCO. Ankesa investigohet nga BCO dhe ankimesit i kthehet përgjigje brenda 3 muajve në rastet e zakonshme dhe nëse çështja është komplekse afati i përgjigjes mund të jetë më i gjatë. Business Ombudsman është ndërmjetës i zgjidhjes së mosmarrëveshjes ndërmjet palëve. Kur mosmarrëveshjet zgjidhen me pajtim, investigimi përfundon. Pavarësisht kësaj Business Ombudsman mund të bëjë rekomandimet përkatëse pranë Qeverisë. Ankesat që shqyrtohen nga Business Ombudsman kanë lidhje me procedurat a) administrative; b) civile; dhe c) penale të ndërmarra ndaj bizneseve nga ana e institucioneve. Tipologjia e ankesave përfshin por pa u kufizuar në a) Çështje që lidhen me taksat dhe tatimet; b) Çështje që lidhen me procedurat doganore; c) Çështje që lidhen me regjistrimin e biznesit; d) Çështjet që lidhen me procedurat penale të nisura ndaj bizneseve; e) Çështje që lidhen me autoritetet lokale; etj.	Jo qartë e përcaktuar në ligj fusha e kompetencave, por nga fryma e ligjit duket sikur sfera e veprimit lidhet me çështjet tatimore dhe fiskale. Raportet e BO i dorëzohen Qeverisë së Gjeorgjisë, Komitetit Buxhetor Financiar dhe Komitetit Sektorial të Ekonomisë dhe Politikës Ekonomike të Parlamentit të Gjeorgjisë.
ÇËSHTJET QË NUK TRAJTON	a)Ankesat që lidhen me mosmarrëveshjet biznes-biznes; b)Ankesat që lidhen me mosmarrëveshjet që janë për shqyrtim përpara gjykatave kompetente ose ato të gjykuara prej tyre, ose kur këto mosmarrëveshje kanë lidhje me vendimet e gjykatave; c)Ankesat e bizneseve kur këto të fundit nuk kanë ezauruar të paktën një procedurë ankimi administrativ sipas kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit kundër të cilit paraqitet ankesa (<i>Neni 6 -Rregullat e Procedurave</i>). Business Ombudsman nuk shqyrton ankesat në lidhje me praktikat e paligjshme të institucioneve për të cilat ka kaluar 1 vit.	N/A

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council